

Shoqëria "GEGA OIL GROUP" SHA.

NIUS K76911001E

Rr: Ali Demi, pranë Karburant Gega Oil, Kati II-të

TIRANË

V E N D I M

Nr. 2/1 datë 20.12.2023

I ASAMBLESE SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË

"GEGA OIL GROUP" SHA.

Sot në Tiranë, më datë 20.12.2023 (dymijë e njëzetëetretë), në selinë e shoqërisë "GEGA OIL GROUP" SHA. me adresë rruga Ali Demi, godina Nr 110, Tiranë, e regjistruar pranë QKB-së, datë 11.07.2007, me aktivitet **Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve**, etj. me aksionarë Z. Paulin GEGA, Z. Genc Gega dhe Z. Klaudio Gega, u shqyrtuan çështjet e rendit të ditës sa më poshtë:

Rendi i ditës:

1. Emërimin e Audituesit ligjor, për hartimin e raportit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë Gega Oil Group SHA.

Në zbatim të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqërite tregtare" dhe të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe vendimit Nr 2 datë 19.05.2023, për destinimin e fitimit, Asambleja e Aksionerëve të shoqërisë pasi përpiloi verbalin e kësaj mbledhje

VENDOSI:

Fitimi prej 148,308,307 lekë të ekspozuar në llogarinë "Fitime e Humbje" të vitit financiar 2022 të shpërndahet si më poshtë:

1. Të zmadhohet **kapitali** në shumën **135,000,000 lekë.**
2. Të zmadhohen **rezervat ligjore** në shumën **3,308,307 lekë.**
3. Të shpërndahet **divident** në shumën **10,000,000 lekë.**

Shuma 148,308,307 lekë.

Fillimin e procedurës për rritjen e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë Gega Oil Group SHA, Tiranë, nëpërmjet rikapitalizimit të fitimit të vitit financiar 2022 nga ana e shoqërisë, gjendje 31.12.2022.

Të caktojë Shoqërinë Audituese "**LIRENG Auditing**" SHPK me NUIS K92302060P, Tiranë, me licensë Nr 148 datë 10.02.2010, për kryerjen e aktit të ekspertimit i cili do të evidentoj rritjen e mësipërme të kapitalit.

Ky vendim merr fuqi nga dita e sotme dhe për përmbajtjen e tij bëhen shënimet përkatëse sipas ligjit si dhe kryhen regjistrimet dhe depozitimet e akteve në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit).

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij të veproj në emër dhe për llogari të shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi dhe akteve shoqëruese të tij pranë QKB-së.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE TË SHOQËRISË
"GEGA OIL GROUP" SHA.

Paulin GEGA



Genc GEGA



Klaudio GEGA



Shoqëria GEGA OIL GROUP SHA
NUIS K76911001E
Rr Ali Demi, pranë Karburant Gega Oil, Kati II-të
Tiranë

V E N D I M
Nr 5, datë 27/12/2023
I ASAMBLESE SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
"GEGA OIL GROUP" SHA.

Sot në Tiranë, më datë **27.12.2023** (dymijë e njëzetë e tre), në selinë e shoqërisë "**GEGA OIL GROUP**" SHA, me adresë Rruga Ali Demi, pranë Karburant Gega Oil, Kati II-të, Tiranë, e regjistruar pranë QKB-së, datë 11.07.2007, me aktivitet **Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve**, etj. me aksionarë Z. Paulin GEGA, Z. Genc Gega dhe Z. Klaudio Gega, u shqyrtuan çështjet e rendit të ditës sa më poshtë:

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i raportit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë **GEGA OIL GROUP SHA.**

Në zbatim të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Asambleja e Aksionerëve të shoqërisë pasi përpiloi verbalin e kësaj mbledhje

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë **GEGA OIL GROPUP SHA**, me fitimet e realizuara, të hartuar nga Shoqëria Audituese "**LIRENG Auditing**" SHPK, me NUIS **K92302060P**, Tiranë, me licensë Nr 148 datë 10.02.2010.
2. Kapitali pas zmadhimit shkon në shumën 1,180,000,000 lekë, i zotëruar nga ortakët:
Z.Paulin Gega, 82% të kapitalit, ose 967,600 aksione me vlerë 1,000 lekë/secili.
Z.Genc Gega, 9% të kapitalit, ose 106,200 aksione me vlerë 1,000 lekë/secili.
Z.Klaudio Gega, 9% të kapitalit, ose 106,200 aksione me vlerë 1,000 lekë/secili.
3. Ky vendim merr fuqi nga dita e sotme, si dhe për përmbajtjen e tij bëhen shënimet përkatëse sipas ligjit si dhe kryhen regjistrimet dhe depozitimet e akteve në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit).
4. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që vet ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi dhe akteve shoqëruese të tij pranë QKB-së.

ASAMBLEJA E AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
"GEGA OIL GROUP" SHA.

Paulin GEGA



Genc GEGA



Klaudio GEGA



Shoqëria GEGA OIL GROUP SHA
NUIS K76911001E
Rr Ali Demi, pranë Karburant Gega Oil, Kati II-të
Tiranë

DEKLARATË

Unë, Olsi Bejta, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë "GEGA OIL GROUP" SHA. me anë të kësaj deklarate vërtetoj me përgjegjësinë time të plotë, referuar Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 178 i tij, se sot, në datën e aplikimit pranë QKB-së, **28.12.2023**, për kryerjen e procedurave të nevojshme për regjistrimin e vendimit të aksionerëve të shoqërisë për zmadhimin e kapitalit dhe të rezervës ligjore, gjendja e aktiveve të shoqërisë është e njëjtë si në ditën kur është marrë vendimi i asamblesë së aksionerëve të shoqërisë për zmadhimin e kapitalit.

Unë si administrator i shoqërisë deklaroj se zmadhimi i kapitalit është ende i mundur.



ADMINISTRATORI
Olisi BEJTA

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Olisi Bejta", written over the printed name and extending over the stamp.